

Mbas çdo akordi një jetë

Konservatori i Shverinit grumbullon partitura dhe dorëshkrime të kompozitorëve të përndjekur nga nazistët. "Qendra e Artit të Përrjashtuar" (Zentrum für Verfremde Kunst) është arkiv kundër harresës. Muzikë për vallëzim e përzier me një fije melankonlie të ëmbël.

Është Pastoralina, një vepër e dalë nga penda e Aldo Finzit. Një kompozitor italian, me prejardhje nga një familje e vjetër hebreje me banim në Milano e që në kohën e vet konsiderohej si një ndër kompozitorët më të talentuar. Derisa nazistët filluan ta përndjekin dhe e detyruan të kalonte në ilegalitet. Tejlodhja fizike dhe psikike ia dobësuan aq shumë gjendjen shëndetësore, sa që në vitin 1945 ai pësoi një infarkt vdekjeprurës. Deri më sot i panjohur. Vetëm në sajë të "Qendrës për Muzikë të Përrjashtuar", pranë Konservatorit të Shverinit ai ka filluar të kthehet në vetëdijen e publikut.

"Një kompozitor me emrin Aldo Finzi, të cilin nuk e njeh askush, kishte qenë jashtëzakonisht i njohur në Shverin dhe kishte patur shumë shfaqje dhe koncerte. I biri, Bruno Finzi, na vuri në dispozicion disa kopje të kompozimeve të tij" (Folker Amels)

Nuk është rasti i vetëm, rrëfen pianisti Folker Amels (Volker Ahmels), një nga nismëtarët e projektit dhe një luftëtar i angazhuar kundër harresës. Ende nuk dihet numri i kompozitorëve dhe muzikantëve që kanë vuajtur në kohën e nazizmit. Një numër i madh veprash konsiderohen të zhdukura. Në arkivin e Shverinit deri tani janë 400 vepra nga 50 kompozitorë.

Folker Amels drejton Qendrën për Muzikë të Përrjashtuar së bashku me muzikologun Birger Petersen dhe kompozitorin francez Filip Olivier (Philippe Olivier). Qëllimi është që t'i sillen sërish publikut veprat që për shkak të përndjekjes së nazistëve, janë lënë në harresë.

"Spektri muzikor është tepër i gjerë. Ai përmban xhaz, muzikë të lehtë, opereta. Ka muzikë mjaft avantgardiste, që sot konsiderohet si muzikë e re, por ka edhe shumë të tjerë që tentojnë më shumë nga romantika. Pra, nuk mund të thuhet se muzika e përrjashtuar i përket një stili të caktuar. Ajo është e shumëllojshme." (Xheni Svenson)

Kërkimi partiturave ose disqeve të gramafonit është i lodhshëm, thotë Xheni Svenson (Jenny Svenson), bashkëpuntorja suedeze e projektit. Shumë kompozitorë nuk kanë lënë dorëshkrime, për të mos folur për xhirime. Kështu që kërkimi bëhet përmes të arfërmve dhe dëshimtarëve të kohës dhe çdo informatë, sado e vogël qoftë, është e mirëseardhur.

Arkivi mbledh edhe interpretë dhe artistë. Kështu për shembull, Edith Kraus, e lindur në vitin 1913, një nga dëshimtarët e pakta që jetojnë ende. Në fillim të shekullit të kaluar, ajo ishte një e ashtuquajtur fëmi-gjeni. Në moshën 11 vjeçare ajo u shfaq për herë të parë si soliste me "Karlsbader Orchester". Në vitin 1926 prindërit e dërguan për studime në Berlin, ku më vonë ajo filloi të punonte si pianiste, derisa erdhën nazistët dhe i dhanë fund karrierës së saj. Sot ajo jeton në Jeruzalem.

Mbas çdo note të arkivit të Shverinit fshihet një jetë, mbas çdo akordi një ngjarje. Dhe kur veprat e heshtura të komponistëve të harruar do ta gjejnë sërish rrugën tek ardashësit, vetëm atëherë edhe harresa do të marrë fund.

Burimi: <http://www.cdodite.com/20080319064238/Mbas-cdo-akordi-nje-jete.html>